



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA ADMINISTRIMIT PYJEVE DHE KULLOTAVE

**PROJEKT-VENDIM**

Nr 09, date 17 / 01 /2024

**Dhenie pelqimi ne parim,per dhenie me qira te pasurise nr 2208,te llojit pylle (shkurre),pjesë te saje,perkatesisht siperfaqen prej 15 ha ,pjesë e pasurise ne fshatin Kolsh Njesia Administrative Kolsh,Bashkia Kukes.Fusha e perdorimit te pronës qe jepet me qera te jete:”Per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit,aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet,bazamentet dhe objektet perkatese etj).**

Bzuar ne nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1/1,2 neni 18,neni 54 shkronja e/l (ndryshuar),neni 55 pika 4,neni 27 pika 5 te ligjit 139/2015”Per vetqeverisjen vendore” (i ndryshuar),Ligji nr 38/2019.ligjit nr.8744 date 22.02.2001 “Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore” i ndryshuar,VKM Nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, i ndryshuar me VKM Nr 684 date 02/09/2020,VKM Nr 888 date 27.12.2022 “Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetar apo zgjerimin e tyre”kreu III pika 2/d,Udhezimi Ministrit te Mjedisit nr 1 date 09/06/2016 “Per rregullat,procedurat e kerkimit,te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjore dhe kullosore publik”pika 7. VKM Nr 559 date 29.07.2022”Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjore kombetar,per veprimtari ekonomike,si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar me VKM Nr 267 date 27.04.2023,ne Vendimin e Kryetarit Bashkise per miratimin e raportit tekniko-ekonomik.

**VENDOSI:**

1.Miratimin ne parim te dhenies me qira me ane te konkurimit me afat 10 vjetar me te drejte rinovimi,te siperfaqes prej 15 ha,te llojit pylle shkurre,pjesë e pasurise nr 2208 ngastrat 113/d dhe 114/a ekonomia pyjore Mamez-Klimash (sipas planit rilevimeve bashkangjitur)fshati Kolsh Bashkia Kukes.

2.Efektet:Jep inpakt pozitiv ne komunitet duke hapur vende te reja pune,si dhe sigurohen te ardhura per bashkine,qe kthehen ne investim publik.

3.Vlera dysheme e qirase vjetore te jete sipas VKM Nr 559 date 29.07.2022"Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjore kombetar,per veprimtari ekonomike,si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" i ndryshuar me VKM Nr 267 date 27.04.2023.

4.Pas miratimit ne keshille dhe shprehjes se ligjshmerise nga ana e Prefektit te Qarkut Kukës sipas pikes 2/d kreu III VKM Nr 888 date 27.12.2022 "*Per rastet e dhenies ne perdorim dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjore kombetar apo zgjerimin e tyre*" do te vazhdohet procedura per dhenien ne perdorim te kesaj pasurie me ane te konkurimit.duke bere shpalljen ne buletin e njoftimeve publike sipas afateve ligjore,dhe me pas duke ndjekur fazat e metejshme deri ne lidhjen e kontrates.

